



Raporti mes vaksinimit dhe mbrojtjes nga infektimi me COVID-19

Me fillimin e pandemisë COVID-19 në dhjetor të vitit 2019¹ filloi edhe mobilizimi për zbulimin e vaksinës anti-covid e cila do të ndalonte përhapjen e infektimit. Pas një viti, në dhjetor të vitit 2020 vakcina Pfizer² u aprovua për përdorim emergjent nga **Agjencioni për Ushqim dhe Barna** ndërsa, pas një kohe të shkurtër janë aprovuar edhe llojet e tjera: Astra Zeneca, Moderna, Johnson & Johnson etj.

Të gjitha llojet e këtyre vaksinave deri më tani janë në dispozicion për personat nga moshë 5 vjeç e më lartë³. Sipas Qendrës për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) “të gjitha llojet e vaksinave të aprovuara deri më tani janë të sigurta, efektive dhe ulin rrezikun e sëmundjes”⁴. Për t’u konsideruar i vaksinuar plotësisht, nevojitet të kalojnë dy javë që nga marrja e dy dozave të vaksinës nga kompania Astra Zeneca, Pfizer dhe Moderna, ndërsa marrja e vetëm një doze e vaksinës Johnson & Johnson. Mirëpo, kohëzgjatja e anti-trupave të fituara pas vaksinimit varet edhe nga imuniteti i personit, pasi jo tek të gjithë personat ndikimi i vaksinës është i njëjtë.

Mirëpo, marrja e dy dozave të vaksinës (apo vaksinimi i plotë) nuk do të thotë që personi i vaksinuar nuk mund të infektohet nga COVID-19. Pra, ka mjaft raste kur edhe personat që kanë marrë dy dozat e vaksinës janë infektuar apo ri-infektuar me COVID-19. Megjithatë, vaksinimi në shumicën e rasteve ofron mbrojtje nga simptoma të rënda dhe shtrimit në spital si pasojë e COVID-19. Sipas një studimi të kryer nga Qendra për Paran-

1 Arsenalut, Anisa. 'A Timeline of Coronavirus (COVID-19)'. *Very Well Health*, 22 dhjetor 2020. <https://dpl.us/gbw>. (Qasur për herë të fundit më 14 dhjetor 2021).

2 U.S Food & Drug. 'FDA Takes Key Action in Fight Against COVID-19 By Issuing Emergency Use Authorization for First COVID-19 Vaccine'. 11 dhjetor 2020. <https://dpl.us/5pk>. (Qasur për herë të fundit më 14 dhjetor 2021).

3 Qendra për Parandalimin e Sëmundjeve dhe Kontrollin. 'Llojet e ndryshme të vaksinës'. 24 nëntor 2021. <https://dpl.us/uuv>. (Qasur për herë të fundit më 10 nëntor 2021).

4 Po aty.

dalimin e Sëmundjeve dhe Kontrollit në ShBA, nga 10,262 raste të infektimit me COVID-19 edhe pas vaksinës, 2,725 e tyre ishin pa simptoma, 995 ishin shtruar në spital ndërsa 160 raste kanë përfunduar me vdekje⁵.

Si qëndron kjo situatë në Kosovë?

Numri i rasteve pozitive me COVID-19 në Kosovë gjatë periudhës 1 gusht - 1 tetor 2021 ka shkuar deri në 2,000 brenda ditës, ndërsa numri i të vaksinuarve ka qenë i ulët⁶. Gjatë kësaj kohe, numri më i madh i personave të shtrirë në spital si pasojë e pandemisë kanë qenë personat e pa vaksinuar.

Sipas Ministrisë së Shëndetësisë (MSh), nga 1 gushti deri më 1 dhjetor 2021 kanë vdekur 1,435 persona të infektuar me COVID-19, prej tyre 1,280 ishin të pa vaksinuar (apo 89 %). MSh-ja ka bërë të ditura këto shifra, duke apeluar se vaksinat kanë rol kyç në parandalimit e infektimit, vdekjeve dhe shtrimeve në spital nga COVID-19⁷.

FIGURA 1: Numri i personave të pa vaksinuar dhe të vaksinuar që kanë vdekur nga COVID-19



Përveç marrjes së dy dozave të vaksinave, me paraqitjen e variantit të ri të COVID-19 i quajtur 'Omicron' në dhjetor të këtij viti, është rritur nevoja për të përforcuar imunitetin e personave tashmë të vaksinuar duke e marrë edhe dozën e tretë. Në Kosovë imunizimi me dozën e tretë ka filluar më 9 gusht 2021⁸. Sipas MSh "doza e tretë u jepet personave të cilët i kanë marrë dy dozat e vaksinës kundër COVID-19, por tek të cilët nuk është zhvilluar imuniteti i duhur, si pasojë e imunitetit të dobët të tyre apo sëmundjeve shoqëruese me rekomandim të mjekut. Doza e tretë jepet jo më herët se 8 javë dhe pa i bërë 6 muaj nga marrja e dozës së dytë⁹.

5 Fischer, Marc. 'Humbja e mbrojtjes nga vakcina anti-COVID-19 raportuar në CDC – Shtetet e Bashkuara të Amerikës, 1 janar-30 prill 2021'. Qendra për Parandalimin e Sëmundjeve dhe Kontrollit. 28 maj 2021. <https://dpl.us/uyv>. (Qasur për herë të fundit më 11 nëntor 2021).

6 Our World in Data. 'COVID-19 vaccine doses, ICU patients, and confirmed deaths'. 20 dhjetor 2021.

7 Koha Ditore. 'Për katër muaj, 89% e të vdekurve nga COVID-19 në Kosovë ishin të pa vaksinuar. 13 dhjetor 2021. <https://dpl.us/479abd>. (Qasur për herë të fundit më 12 dhjetor 2021).

8 Ministria e Shëndetësisë. 'Msh vendosë për marrjen e dozës përforcuese'. 8 dhjetor 2021. <https://dpl.us/hgp>. (Qasur për herë të fundit më 11 nëntor 2021).

9 Po aty.

Sipas studimeve të fundit ky variant mund të bëhet dominues në shumë vende, posaçërisht në Mbretërinë e Bashkuar, mirëpo studiuesit konstatojnë se ky variant mund të jetë më i lehtë për personat e vaksinuar si dhe marrja e dozës përforcuese ka mundësi që të zbusë përhapjen e variantit të ri 'Omicron'¹⁰.

PËRFUNDIM:

Për t'u mbrojtur nga COVID-19 është e nevojshme vaksinimi i plotë (me dy doza) por tashmë edhe me dozën e tretë për personat me imunitet të dobët apo me sëmundje shoqëruese. Edhe nëse vaksinat nuk ofrojnë mbrojtje totale nga infektimi me COVID-19, ato ulin mundësinë e shtrimit në spital si dhe sëmundjes në formë të rëndë. Mirëpo, vaksinimi nuk do të thotë mos përdorimin e maskave dhe mbajtjen e distancës prej 1.5 metra. Pra, respektimi i rekomandimeve nga ekspertët shëndetësor dhe i masave të vendosura nga Qeveria, duhet të aplikohen pa përjashtim nga personat e vaksinuar njësoj si për ata të pa vaksinuar. E gjitha kjo për ruajtjen e shëndetit individual dhe kolektiv nga COVID-19.

¹⁰ Barnard, Rosanna C & Davies, Nicholas G. 'Modelimi i pasojave potenciale nga varianti Omicron SARS-CoV-2 në Angli'. Centre for Mathematical Modelling of Infectious Diseases. 11 dhjetor 2021. <https://dpl.us/cji>. (Qasur për herë të fundit më 11 nëntor 2021).

